



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT Arkivi Qendror - Centralno Arhiva - Central Archive
Nr./Br.No. <u>1283/2</u>
Nr. I fq./Br. Str./No. pg <u>1+12</u>
Data/Datum/Date: <u>30-03-2023</u> PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 30.03.2023

Ref. KM-118/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10, 11 dhe nenin 30 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr.7/ 01 mars 2019), nenin 9 të Rregullores (QRK)-NR.3/2020 për Përformancën e Agjencive, dhe nenin 8 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.4, nenin 15 Shtojcën 11 të Rregullores (QRK)-NR.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

V E N D I M

1. Miratohet Plani i Përformancës për Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë për vitin 2023 në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural



Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit,
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm,
- Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë,
- Zyrës së Kryeministrit, dhe
- Arkivit.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
 MINISTERIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHYLLIMIT RURAL
 MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
 MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
 Arkivi Qendror - Centralna Arhiva - Central Archive

Nr./Br./No. 1283
 Nr. i fq./Br. Str./No. pag. 12
 Data/Datum/Date: 30.03.2023
 PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
 MINISTERIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHYLLIMIT RURAL
 MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
 MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
 AGENCIJA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË - AGENCIJA ZA RAZVOJ POLJOPRIVREDE
 AGENCY FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT

Hesba Org. 07/4
 Org. Jedin. 1867
 Org. Unit
 Nr. i faqesh 12
 Broj stranica
 No. pages: 29.03.2023
 PRISHTINE-A

Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria -Vlada - Government
 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
 Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva
 i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry And Rural Development
 Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë
 Agencija za Rzvoj Poloprivrede / Agriculture Development Agency

REF.	
DATË/A:	29 mars 2029
PËR/ZA/TO:	z. Faton Peci – Ministër i MBPZHR-së
CC:	z. Blerim Hasani – Sekretar i Përgjithshëm, MBPZHR-së
NGA/OD/FROM:	Venera Çerkini, Drejtore Ekzekutive në AZhB <i>Çerkini</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për miratimin e Planit të Përformances për vitin 2023

I nderuar Ministër,

Bazuar në obligimet që dalin nga Ligji për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, si dhe Rregullores për Përformancën e Agjencive bashkangjitur gjeni Planit të përformances për vitin 2023.

Planit i përformances është hartuar duke u bazuar në udhëzimet përkatëse të Rregullores dhe konsiderojmë dokumentin final nga ana jonë.

Andaj, ju lutem që bazuar në kompetencat ligjore ta miratoni planin e përformances për vitin 2023.

Paraprakisht duke ju falënderuar në mirëkuptimin tuaj.

Me respekt,

Venera Çerkini
 Drejtore Ekzekutive

Bashkangjitur:

- Plani Përformances;
- Draft vendimi për miratimin e PP;
- Vendimi i ekipit hartues;



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja / Ministry of Agriculture,
Forestry and Rural Development

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë
Agencija za Rzvoj Poloprivrede / Agriculture Development Agency

Plani i performancës për vitin 2023

Përmbajtja

I. Përmbledhja ekzekutive.....	3
II. Shkurtesat.....	3
III. Agjencia për zhvillimin e bujqësisë.....	4
IV. Struktura e planit të performancës.....	5
V. Tabela e planit të performancës.....	8

I. Përmbledhja ekzekutive

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë është themeluar me Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural nr.04/L-090 për ndryshim plotësimin e Ligjit me nr.03/L-98 si Agjenci Ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Bazuar në Ligjin BZHR dhe në rregulloren Nr.01/2012 për Detyrat, Përgjegjësitë, Kompetencat dhe Strukturën Organizative, Agjencisë i përcaktohet roli si agjenci ekzekutive e cila merret me implementimin e programeve për mbështetje në bujqësi dhe zhvillim rural.

Agjencia aktualisht është në fazën e hartimit të rregullores për detyrat, përgjegjësit, kompetencat dhe strukturën organizative, qe për synim ka ristrukturimin e agjencisë bazuar ne standardet sipas Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, si dhe synimin e përmbushjes së obligimeve të Marrëveshjes së Partneritetit për Kornizën Financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian për Marrëveshjet për Zbatimin e Ndihmës Financiare të Unionit për Kosovën në kuadër të Instrumentit të Para-anëtarësimit, rrjedhimisht përmbushjen e parakushteve për agjenci IPARD. Në këtë kuptim me qëllim të përkrahjes, GIZ me kërkesë të Ministrisë ka angazhuar ekspert përkatës në përkrahje të Ministrisë dhe AZHB-së, fillimisht për identifikimin e hapave konkret dhe njëkohësisht ofrimin e rekomandimeve për ndërmarrjen e veprimeve bazuar në përvojat e shteteve të cilat kanë kaluar fazat transformimit të Agjencive te pagesave në Agjenci IPARD.

II. Shkurtesat

MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
AZHB -Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë PBZHR Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
AM – Autoriteti Menaxhues;
PZHR – Projektet e Zhvillimit Rural;
PD - Pagesat Direkte;
LPIS – Sistemit të Integruar të Manaxhimit dhe Identifikimit të Parcelave;
NIF - Numri Identifikues i Fermës;
PZHR – Projektet e Zhvillimit Rural;
TI - Teknologjia e Informacionit;
U/A – Udhëzimi Administrativ ;
BMA - Bimët mjekësore dhe aromatike;
OJQ - Organizatë joqeveritare;
GLV - Grupet lokale të veprimit;
BB - Banka Botërore;
BE – Bashkimi Evropian;
KE - Komisioni Evropian;
DBE - Delegacioni i Bashkimit Evropian;
RRDHKF - Rrjeti i të dhënave të kontabilitetit të fermave;
FAO - Organizata e Bujqësisë dhe Ushqimit e Kombeve të Bashkuara;
IPA - Instrumenti i Para-anëtarësimit;
IPARD - Instrumenti i Para-anëtarësimit për Zhvillim Rural;

III. Agjencia për zhvillimin e bujqësisë


Misioni - Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë është përgjegjëse për implementimin e programeve mbështetëse për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, duke zbatuar procedurat e shkruara, të cilat janë të bazuara në IPARD.

Është përgjegjëse për implementimin e masave për mbështetje nga programi nacional, donatorët dhe në një të ardhme shumë të afërt edhe i masave nga programi i para anëtarësimit për Zhvillim Rural. Gjatë këtij procesi, Agjencia është përgjegjëse për publikimin e thirrjes, zbatimin e procedurave të aplikimit, kontrollit administrativ, kontrollit në terren, si dhe miratimit dhe ekzekutimit të pagesave deri tek përfutjesi.

Vizioni - Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë ka për qëllim lidhjen e fermerit kosovar me institucione në nivelin nacional dhe atë evropian, e cila përmes programeve për mbështetje financiare ndikon në zhvillimin e këtij sektori të rëndësishëm të ekonomisë.


Përmes programeve për mbështetje dhe procedurave transparente dhe të qarta, dëshirojmë që fermerëve të ju mundësojmë qasje në fondet për zhvillim në bujqësi dhe zhvillim rural.

Organizimi i AZhB-së - Agjencia në kuadër të Ministrisë është organizuar sipas Ligjit për Bujqësi si Agjenci e pagesave dhe në strukturën aktuale ka të punësuar një numër të kufizuar zyrtarësh në raport me nevojat për përmbushje të detyrave. Skema organizative e Agjencisë aktualisht është në përbërje sipas strukturës organizative, skema në vijim:



Numri aktual i të punësuarve në AZHB është 85 zyrtarë publike me akt emërimi të rregullta, ndërsa sipas ligjit të buxhetit për vitin 2023 janë të buxhetuara 113 pozita.

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë synon që të zbatoj në mënyrë efikase kompetencat e saj për zhvillimin bujqësor dhe rural në Republikën e Kosovës përmes zbatimit të programeve mbështetëse, të financuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, Instrumenti i Para-Anëtarësimit për Zhvillim Rural (IPARD) dhe donatorë të tjerë. Implementimi i programeve realizohet në përputhje me rregullat dhe procedurat ligjore, si dhe standardet tjera, që përfshijnë aplikimin, kontrollin administrativ, kontrollin në terren, miratimin dhe ekzekutimin e pagesave tek përfituesi, gjithashtu edhe implementimin e skemave përkrahëse përmes pagesave direkte. AZHB gjatë vitit 2023 synon miratimin organogramit të brendshmen të Agjencisë, aktualisht është duke hartuar draft dokumenti me përkrahjen e ekspertit ligjor nga GIZ. Në vijim struktura organizative e Agjencisë e paraqitur ne tabelë është si në vijim:



IV. Struktura e planit të performancës

Agjencia që nga themelimi i saj është përballë me sfida nga me të ndryshmet duke filluar nga mungesa e funksionalizimit të plotë dhe fuqizimit të saj si mekanizëm për implementim të programeve për zhvillimin e bujqësisë. Sfidë e veçantë e ka përcjellë Agjencinë mungesa e vazhdueshme e stafit përkatës, mungesa e hapësirave të domosdoshme për sistemim të stafit, hapësira për arkivim të dokumentacionit, mjetet e nevojshme logjistike në teren, mungesa e pajisjeve të TI, mungesa e sistemeve elektronike të avancuar për menaxhim të grandeve dhe pagesave direkte, mungesa e përditësimit të sistemit sLPIS, etj.

Nisur nga të lartë cekurat Agjencinë edhe një periudhë e ardhshme do të jete sfiduese sa edhe kjo e kaluara. Disa nga çështjet që kërkojnë vëmendje të veçantë dhe zgjidhjen e tyre gjatë vitit 2023, do të jenë:

- Hartimi rregullores së brendshme dhe ngritja e kapaciteteve sipas organogramit që miratohet;
- Zbatimi i Programit për Zhvillim Rural – miratimi i projekteve;
- Zbatimi i programit për zhvillim rural 2022– autorizimi i pagesave;
- Zbatimi i Programit të Pagesave Direkte në Bujqësi për vitin 2023;

- Realizimi i Kontrollit në teren për Masat e parapara me Programet Mbështetëse të MBPZHR/2022 dhe 2023;

Objektivi I - Hartimi i rregullores dhe ngritja e kapaciteteve sipas rregullores se miratuar

Përmes kësaj objektive AZHB synon organizimin e plotë të strukturës organizative sipas rregullores që do të miratohet në Qeveri, rrjedhimisht synohet funksionalizimi i të gjitha njësive organizative me zyrtaret në kompetencë profesionale duke respektuar përcaktimin e rregullave, standardet dhe procedurat ligjore për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në AZHB. Përmes këtij objektivi do të krijohet parakushti primar për implementimit programeve për zhvillimin e bujqësisë me efektivitet duke respektuar plotësisht të procedurave ligjore si dhe kriteret e përcaktuara sipas UA.

Aktivitetet të cilat do të ndermirën për realizimin e kësaj objektive janë:

Aktiviteti 1 - Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës sipas organogramit të miratuar, fillimisht duke i sistemuar stafin aktual të AZHB-së;

Aktiviteti 2 - Plotësimi i pozitave të lira përmes procedurave të konkursit, pozita të cilat janë përkrahura me buxhet për vitin 2023;

Aktiviteti 3 – Rritja e kontrollit të brendshëm bazuar në legjislacionin në fuqi si dhe përmes forcimit auditimit të brendshëm;

Aktiviteti 4 – Ngritja e infrastrukturës teknologjike - dixhitalizimi i sistemeve për menaxhimin procedurës administrative gjatë implementimit të programeve për zhvillimin e bujqësisë.

Objektivi II - Zbatimi i Programit për Zhvillim Rural – Miratimi i Projekteve

Aktivitetet të cilat do të ndermirën për realizimin e kësaj objektive janë:

Aktiviteti 1 - Publikimi i thirrjes për aplikim për PZHR 2023;

Aktiviteti 2 - Kontrolli administrativë vlerësimi i projekteve për PZHR;

Aktiviteti 3 - Publikimi i përfituesve të mundshëm dhe atyre të kontraktuar;

Aktiviteti 4 -Vlerësimi raporteve të kontrollit nga terreni dhe miratimi apo refuzimi projekteve. Të gjitha këto aktivitete do të kryhen sipas kriterëve të parapara me U/A përkatës dhe dokumente tjera dhe miratimi /kontraktimi.

Objektivi III - Zbatimi i programit për zhvillim rural 2022 – Autorizimi i pagesave

Aktivitetet të cilat do të ndermirën për realizimin e kësaj objektive janë:

Aktiviteti 1 - Planifikimi i aktiviteteve për autorizimin e pagesave: Plani i aktiviteteve për realizimin e Autorizimit të pagesave do të jete pjesë e Planit të AZZHB-së;

Aktiviteti 2 - Pranimi i Kërkesave për Paradhënie dhe Pagesë për programin e vitit 2022: Kontrolli administrativë i dokumentacionit (kontrolli i pranueshmerisë), përgatitja e urdhrat për kontroll të II në

vend ngjarje (teren) për projektet e vitit 2022 dhe projektet e vitit 2023 nëse arrihet të miratohen dhe kontraktohen gjate vitit 2023.

Aktiviteti 3 - Analiza e raportit të kontrollit të dytë në vend ngjarje (teren) nga ekipet e caktuar në parimin 4 sy: me raportin e parë, Planin e Biznesit, Letrën Informuese të Miratimit të PZHR-së, dhe dokumentacionit tjetër të nevojshëm sipas U/A për vitin përkatës (faturat dhe fletëpagesat bankare, lejet ndërtimore, certifikatat për origjinë të fidanëve, licencat raportet e AUV për plotësimin e standardeve nacionale etj), përgatitja e listave dhe kërkesave për ekzekutimin e pagesave;

Aktiviteti 4 - Analiza e raporteve nga kontrollet e rregullta, super kontrolli, raportet e Auditorit të brendshëm dhe të jashtëm, menaxhimi i rrishtit dhe konfliktit te interesit etj.

Objektivi IV - Zbatimi i Programit të Pagesave Direkte në Bujqësi 2023

Aktivitetet të cilat do të ndermirën për realizimin e kësaj objektive janë:

Aktiviteti 1 – Përgatitja e thirrjes për aplikim dhe rifreskimi i doracakut të procedurave të punës;

Aktiviteti 2 - Kontrolli i kompletshmërisë dhe pranueshmërisë së një aplikacionit;

Aktiviteti 3 - Kontrolli administrativ i aplikacionit;

Aktiviteti 4 - Kontrolla në teren;

Aktiviteti 5 - Llogaritja e shumës së përkrahjes së pagesave direkte;

Aktiviteti 6 - Përgatitja e vendimit dhe autorizimi i pagesave;

Objektivi V - Realizimi i Kontrollit në teren për Masat e parapara me Programet Mbështetëse të MBPZHR/2022 dhe 2023. Menaxhimi dhe Organizimi i duhur i qarkullimit të lëndëve dhe kontrolleve në teren për të gjitha masat mbështetëse, përballimi i sasisë së kontrolleve dhe mbikëqyrja e cilësisë së realizimit të kontrollit.

Aktivitetet të cilat do të ndermirën për realizimin e kësaj objektive janë:

Aktiviteti 1 - Përgatitja e formularëve, doracakëve dhe përshkrimi i procedurave për Implementim të kontrollit në teren;

Aktiviteti 2 – Ngritja e kapaciteteve dhe hapja e debateve me Inspektoratin e terrenit lidhur me Programet për Procedurat dhe Metodrat e kontrollit në teren;

Aktiviteti 3 – Menaxhimi i dokumentacionit të kontrollit dhe lendeve te pranuar nga departamentet e pranuar përmes kërkesave për kontrolla në terren dhe verifikimi i gjendjes;

Aktiviteti 4 - Mbikëqyrja e ekipeve qe realizojnë kontrollat, vlerësimi, verifikimi dhe kthimi i lëndëve në departamentet përkatëse.

V. Tabela e planit të performancës

Objektivi	Aktivitetet	Afati	Institucioni Kontribuues	Synimet	Koordinimi
Objektivi I - Hartimi i rregullores dhe ngritja e kapaciteteve sipas rregullores së miratuar	Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës sipas organogramit të miratuar, fillimisht duke i sistemuar stafin aktual të AZHB-së.	K2- K4	MBPZHR/AZHB/MPB/MFPT/donatorë	Realizimi i organizimit të brendshëm dhe sistematizimit	MBPZHR
	Plotësimi i pozitave të lira përmes procedurave të konkursit, pozita të cilat janë përkrahura me buxhet për vitin 2023	K2 – K4	AZHB/MPB	Plotësimi i pozitave	MBPZHR
	Rritja e kontrollit të brendshëm bazuar në legjislacionin në fuqi duke si dhe përmes forcimit auditimit të brendshëm.	K1 – K4	MBPZHR/AZHB/ZKA/MFPT	Rritja e kontrollit dhe menaxhimi i rrezikut	MBPZHR
	Ngritja e infrastrukturës teknologjike-dixhitalizimi i sistemeve për menaxhimin procedurës administrative gjatë implementimit të programeve për zhvillimin e bujqësisë.	K2 – K4	MBPZHR/ASHI/GIZ	Avancimi i TI	MBPZHR
Objektivi II Zbatimi i Programit për Zhvillim Rural – Miratimi i Projekteve	Publikimi i thirrjes për aplikim për PZHR 2023	K2-K3	AZHB - DMPZHR – AM, DAP, DTI&R	Miratimi me kohë i Programit për PZHR dhe U/A dhe publikimi me kohë i thirrjes për aplikim	Drejtori Ekzekutiv, DZHPR/AM - MBPZHR
	Kontrolli administrativë vlerësimi i projekteve për PZHR.	K3	AZHB DMPZHR	Implementimi i procedurave për kontrollë administrative dhe vlerësimi i projekteve sipas kritereve të përcaktuara me UA	Drejtori Ekzekutiv, DA, DTI&R, AKK, AUV etj

	Publikimi i përfituesve të mundshëm dhe atyre të kontraktuar	K3-K4	AZHB DMPZHR	Publikimi i listës së rezultateve preliminare para miratimit Publikimi i listës së projekteve të kontraktura	Drejtori Ekzekutiv, DA, DTI&R
	Vlerësimi raporteve të kontrollit nga terreni dhe miratimi apo refuzimi projekteve. Të gjitha këto aktivitete do të kryhen sipas kriterëve të parapara me U/A përkatës dhe dokumente tjera dhe miratimi /kontraktimi	K3-K4	AZHB – DMPZHR	Miratimi /kontraktimi sipas planit operacional duke përfshirë edhe periudhat vegetative	Drejtori Ekzekutiv, DA, DTI&R, DK
Objektivi III - Zbatimi i programit për zhvillim rural 2022– Autorizimi i pagesave.	Planifikimi i aktiviteteve për autorizimin e pagesave: Plani i aktiviteteve për realizimin e Autorizimit të pagesave do të jetë pjesë e Planit të AZZHB-së	K1	Departamenti aprovim të projekteve , AM-MBPZHR	Planifikim sa më i saktë i aktiviteteve për autorizim të pagesave sipas afateve	Drejtori Ekzekutiv, Departamenti i aprovim, Departamenti i kontrollit, etj
	Pranimi i Kërkesave për Paradhënie dhe Pagesë për programin e vitit 2022: Kontrolli administrativë i dokumentacionit (kontrolli i pranueshmerisë), përgatitja e urdhrave për kontroll të II në vend ngjarje (teren) për projektet e vitit 2022 dhe projektet e vitit 2023 nëse arrihet të miratohen dhe kontraktohen gjatë vitit 2023	K1-K4	Departamenti aprovim të projekteve, drejtoria e kontrollit, ZL	Zbatimi i kriterëve të përcaktuara për autorizim të pagesave dhe afateve të vendosura	Drejtori Ekzekutiv, Departamenti i aprovim, Departamenti i kontrollit, etj
	Analiza e raportit të kontrollit të dytë në vend ngjarje (teren) nga ekipet e caktuar në parimin 4 sy: me raportin e parë, Planin e Biznesit, Letrën Informuese të Miratimit të PZHR-së, dhe dokumentacionit tjetër të nevojshëm sipas U/A për vitin përkatës (faturat dhe fletëpagesat bankare, lejet ndërtimore, certifikatat për origjinë të fidanëve, licencat raportet e AUV për plotësimin e standardeve nacionale etj), përgatitja e listave dhe	K1-K4	Departamenti aprovim të projekteve, drejtoria e kontrollit, ZL	Zbatimi i kriterëve të përcaktuara për autorizim të pagesave dhe afateve të vendosura	Drejtori Ekzekutiv, Departamenti i aprovim, Departamenti i kontrollit, etj

	kërkesave për ekzekutimin e pagesave				
	Analiza e raporteve nga kontrollet e rregullta, super kontrolli, raportet e Auditorit të brendshëm dhe të jashtëm, menaxhimi i rrishtit dhe konfliktit të interesit etj	K4	Departamenti kontrollit, AB	Shtimi i kontrollit në zbatimin e kriterëve	Drejtori Ekzekutiv dhe AB
Objektivi IV - Zbatimi i Programit të Pagesave Direkte në Bujqësi 2023	Përgatitja e thirrjes për aplikim dhe rifreskimi i doracakut të procedurave të punës	K1 K2		Zbatimi me kohë të PPD duke u bazuar në kriteret e përcaktuara me UA	Në koordinim me DK, DF, DPBT etj.
	Kontrolli i kompletshmërisë dhe pranueshmërisë së një aplikacionit	K2		Rreth 35,000 aplikacione të kontrolluara me saktësi	
	Kontrolli administrativ i aplikacionit	K1			
	Kontrolli në terren	K2		Rreth 35,000	
	Llogaritja e shumës së përkrahjes së pagesave direkte	K3		vendime për	
	Përgatitja e vendimit dhe autorizimi i pagesave	K4		pagesë të përgatitura me kohë	
Objektivi V - Realizimi i Kontrollit në terren për Masat e parapara me Programet Mbështetëse të MBPZHR/2022 dhe 2023. Menaxhimi dhe Organizimi i duhur i qarkullimit të lëndëve dhe kontrolleve në terren për të gjitha masat mbështetëse, përballimi i sasisë së kontrolleve dhe mbikëqyrja e	Përgatitja e formularëve, doracakëve dhe përshkrimi i procedurave për Implementim të kontrollit në terren	K1	MBPZH, DMPZHR, DAP, DPD, Zyra Ligjore	Krijimi dhe njohja e bazës Ligjore të operimit në terren	Drejtori Ekzekutiv
	Ngritja e kapaciteteve dhe hapja e debateve me Inspektoratin e terrenit lidhur me Programet për Procedurat dhe Metodën e kontrollit në terren	K1-K2	DMPZHR, DAP, DPD	Përgatitja e dhe detajimi i procedurave	Drejtori Ekzekutiv
	Menaxhimi i dokumentacionit të kontrollit dhe lendeve të pranuar nga departamentet e pranuar përmes kërkesave për kontroll në terren dhe verifikimi i gjendjes	K1,K2, K3,K4	DMPZHR, DAP, DPD		Drejtori Ekzekutiv, DMPZHR, DAP, DPD
	-Mbikëqyrja e ekipeve që realizojnë kontrollat, vlerësimi, verifikimi dhe kthimi i lëndëve në departamentet përkatëse	K1 K2 K3		Realizimi i kontrollave që parashihen sipas Programeve	

cilësisë së realizimit të kontrollit.	-Bazuar ne programet mbështetëse kontrollat për vitin 2023. - Kontrollat sipas PZHR 2022: Kontrolli i Parë-Para Miratimit 233 - 240	K4	DMPZHR, DAP, DPD	2022 dhe 2023. Numri aktual i inspektoreve është 30. Për realizimin me sukses dhe efektiv duke nënkuptuar edhe cilësinë e kontrollave në teren nevojiten minimum edhe 38 inspektor. Në total duhet të jete numri prej 68 inspektoreve përkatësisht 34 ekipe.	Drejtori Ekzekutiv, DMPZHR, DAP, DPD
	Kontrolli i Dytë-Para Pagesës – 545	K1			
	-Kontrollat sipas PZHR 2023: Kontrolli i Parë-Para Miratimit 500;	K2			
	Kontrolli i Dytë-Para Pagesës 150-200;	K3			
	- Kontrollat sipas PPD 2022 diku 100; -Kontrollat sipas PPD 2023 përfshin 25% e aplikacioneve te cilat pritet te arrijnë numrin prej 40000 aplikacione duke përfshi me shume se një masë. Rrjedhimisht nga kjo nënkuptohet qe munde kërkohen rreth 10000 kontrollat në teren.	K4			